



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL  
PËR VITIN 2021**

**Prishtinë, qershor 2022**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Te neni 14 "Raporti i ekzekutimit të buxhetit" në PFV, të hyrat e realizuara nga donatorët ishin mbivlerësuar për 371,275€; dhe
- B1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 143,554€ si rezultat i mos-bartjes së pronësisë së projekteve të përfunduara për komuna dhe mos-aplikimit të zhvlerësimit tek pasuritë jo-kapitale.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MAPL kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## **Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Ministri është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Ministri është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Rëndësi të veçantë Ministria duhet t'i kushtojë përgatitjes së PFV-ve të cilat përmbanin vlera jo të sakta dhe të plota sa i përket pasurive kapitale si dhe gabime në prezantimin e të hyrave të realizuar nga donatorët. Po ashtu, Ministria duhet të funksionalizojë Komitetin e auditimit si dhe në bashkëpunim me Thesarin të mbyllë avancet.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre kemi një (1) rekomandim të ri dhe tri (3) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Paraqitje jo e saktë e të hyrave të pranuar nga donatorët në PVF

##### Gjetja

Neni 24 i "Rregullores MF - nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore" përcakton: Organizatat buxhetore raportojnë për të hyrat, pagesat, kthimet e donacioneve si dhe bilancin e fondeve për bartje sipas donatorëve.

Tek neni 14 "Raporti i ekzekutimit të buxhetit" të PFV-ve – Grantet e përcaktuara të donatorëve - të hyrat e realizuara nga donatorët për vitin 2021 ishin prezantuar në vlerë 561,090€, ndërsa sipas shënimeve të SIMFK do të duhej të prezantoheshin 189,815€. Si rezultat vlera e prezantuar e të hyrave të realizuara nga grantet e donatorëve ishte mbivlerësuar për 371,275€.

Kjo ka ndikuar edhe në prezantimin jo të saktë të Shënimit 11 "Grantet e përcaktuara të donatorëve".

Kjo ka ndodhur si rezultat i paqartësisë lidhur me prezantimin e këtyre donacioneve nga zyrtarët përgjegjës.

##### Ndikimi

Mos-paraqitja e saktë e të hyrave të pranuar nga donatorët në vitin 2021 ka ndikuar në mbivlerësim të gjendjes së tyre në PVF.

##### Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë se të hyrat e realizuara nga donatorët paraqiten/prezantohen saktë dhe drejtë në PFV-të e vitit 2022.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë****Gjetja**

Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimit e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës.

Ne kemi evidentuar gjashtë (6) projekte të bashkëfinancuara për komuna në vlerë totale prej 139,056€ edhe pse ishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre nga komisionet përkatëse, ato vazhdojnë të figurojnë në regjistrin e Ministrisë si investim në vijim, duke mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale për këtë vlerë. Projektet janë si në vijim :

- Projekti "Ndërtimi i Liqenit Akumules hapja e pusëve për ujë të pijes" në Komunën e Klinës, vlera e financuar nga MAPL 15,000€, pranimi teknik ishte bërë me datën 02.08.2021;
- Projekti "Trajtimi i kanalizimeve fekale (Gropa septike) në komunën e Rahovecit, vlera e financuar nga MAPL 20,000€, pranimi teknik ishte bërë me datën 26.07.2021;
- Projekti "Punime në sallën e Kuvendit Komunal, Inventar, zërim dhe paisje të IT" - Komuna e Vitisë, vlera e financuar nga MAPL 35,080€, pranimi teknik ishte bërë me datën 23.12.2019;
- Projekti "Furnizim dhe blerja e pompës për furnizim me ujë" Komuna e Zveqanit, vlera e financuar nga MAPL 10,000€, pranimi teknik ishte bërë me datën 24.12.2019;
- Projekti "Asfaltimi i rrugëve lokale Shtupel-Kërrnicë" Komuna e Klinës, vlera e financuar nga MAPL 28,976€, pranimi teknik ishte bërë me datën 03.12.2021 si dhe
- Projekti "Rehabilitimi i Bulevardit Ismail Raka & Qamil Ilazi" Komuna e Kaçanikut, vlera e financuar nga MAPL 30,000€, pranimi teknik ishte bërë me datën 20.08.2021.

Më tutje, neni 22 paragrafi 3 i po të njejtës rregullore përcakton se: Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Gjatë testimit identifikua që pasuria jo-kapitale nga regjistri E-pasuria e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë pasi që nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Në 18 raste të testuara pasuritë jo-kapitale ishin mbivlerësuar për 4,498€ si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos koordinimit ndërmjet zyrtarëve të Ministrisë dhe atyre të Komunave si dhe problemeve të vazhdueshme në funksionalitetin e sistemit e-pasuria.

**Ndikimi**

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat si dhe mos-aplikimi i zhvlerësimit të pasurive jo-kapitale ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

**Rekomandimi B1** Ministri në bashkëpunim me departamentin e monitorimit të komunave duhet të sigurojë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive azhurnohet dhe të gjitha projektet e përfunduara bashkëfinancime për komuna barten në pronësi të tyre. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet zhvlerësimi i pasurive jo-kapitale me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në vitin 2021 ishte 1,043,218€ ndërsa prej tyre ishin shpenzuar 326,573€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me avance për udhëtime zyrtare, shërbime tjera kontraktuese, dreka zyrtare etj.

#### Çështja B2 - Avancet e pambyllura nga vitet paraprake

**Gjetja** Në bazë të rregullës financiare nr.01/2013 MF- shpenzimi i parave publike dhe udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare nr. MShP 2004/7, avancet për udhëtime zyrtare duhet të mbylLEN dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar

MAPL, në nenin 20 në Raportin Vjetor Financiar (RVF), kishte paraqitur avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë 5,945€ nga vitet paraprake 2010-2014. Edhe pse MAPL kishte dëshmi se avancet ishin mbyllur, në SIMFK ato vazhdojnë të figurojnë të hapura. MAPL kishte bërë kërkesë në Thesar për t'i korrigjuar këto avance duke dërguar dokumentacionin e duhur por ende nuk ishte arritur ndonjë rezultat. Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitet paraprake por gjendja vazhdon të jetë e njëjtë.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit të mirë në mes të zyrtarëve përgjegjës të MAPL-së dhe Thesarit.

**Ndikimi** Vonesa në mbylljen e avanceve ndikon në mos evitimin e gabimeve në llogarinë e avanceve, dhe pasqyron shpenzime të pambyllura duke bërë që kjo llogari të figurojë e hapur në vazhdimësi. Po ashtu, informatat e prezantuara në PFV nuk prezantojnë gjendjen reale të avanceve të ministrisë.

**Rekomandimi B2** Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dokumente mbështetëse, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Në kuadër të MAPL-së është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm e cila operon me 3 anëtar (Drejtori dhe dy auditor). NJAB kishte përfunduar pesë (5) raporte aq sa i kishte planifikuar si dhe dy auditime ad-hoc. Po ashtu MAPL kishte themeluar Komitetin e Auditimit por ky komitet nuk ishte funksional.

### Çështja B3 - Mos funksionimi i Komitetit të auditimit

**Gjetja** Udhëzimi administrativ MF - NR. 01 / 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4 “1.Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i Auditimit ishte formuar në qershor të vitit 2021 por ky komitet nuk kishte qenë funksional dhe nuk kishte mbajtur asnjë takim gjatë vitit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos bashkëpunimit të Komitetit të auditimit dhe NJAB-së.

**Ndikimi** Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit pamundëson përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NJAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>4,597,675</b>	<b>6,020,849</b>	<b>3,871,569</b>	<b>2,931,994</b>	<b>4,760,820</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	4,597,675	4,902,520	3,576,725	2,849,013	3,714,414
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	919,787
Donacionet e jashtme	0	1,118,330	294,844	82,982	126,619

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,423,175€. Ky ndryshim ishte rezultat i rishikimit buxhetor, ndarjes së fondeve të donatorëve si dhe kursimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2021 MAPL kishte shpenzuar 3,871,569€ apo 64% të buxhetit final me një ulje prej 10% në raport me vitin paraprak. Pra realizimi i buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel të pakënaqshëm dhe shpenzimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>4,597,675</b>	<b>6,020,849</b>	<b>3,871,569</b>	<b>2,931,994</b>	<b>4,760,820</b>
Pagat dhe mëditjet	968,996	986,170	926,987	969,397	1,022,588
Mallrat dhe shërbimet	263,179	1,036,653	321,568	121,183	254,288
Komunalitë	15,500	6,565	5,005	5,140	8,394
Investimet Kapitale	3,350,000	3,991,461	2,618,008	1,836,273	3,475,551

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 17,174€. Ky ndryshim ishte rezultat i fondeve të alokuara nga donatorët në vlerë 182,586€ si dhe rezultat i vendimeve qeveritare për kursime në vlerë 165,412€. Realizimi i buxhetit final ishte 94%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 773,474€. Kjo rritje ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 8,000€, ndarje e mjeteve nga fondet e donatorëve në vlerë 852,767€ si dhe reduktim i fondeve me vendime qeveritare në vlerë 87,293€. Buxheti në këtë kategori ishte realizuar vetëm 31% dhe ky nivel i ulët i shpenzimit kryesisht kishte ardhur si rezultat i mos-realizimit të fondeve të alokuara nga donacioni i Bankës Botërore ku nga 698,402€ mjete të alokuara në vitin 2021 në kategorinë mallra dhe shërbime, ishin shpenzuar vetëm 71,837€ apo 10% e këtyre fondeve.

Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 8,935€ dhe ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë 8,000€ dhe vendimeve për kursime buxhetore në vlerë 2,562€. Po ashtu kishte ndarje nga fondet e donatorëve në vlerë 1,627€.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 641,461€. Ky ndryshim ishte rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë 1,200,000€, alokimit të mjeteve nga fondi i donatorëve në vlerë 81,350€. Po ashtu kishte reduktim të mjeteve me vendime qeveritare në vlerë 639,888€. Në këtë kategori buxheti ishte realizuar vetëm 66% si rezultat i mos-realizimit të plotë të projekteve të planifikuara me buxhet.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MAPL-së ka rezultuar në katër (4) rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, një (1) rekomandim ishte zbatuar dhe tri (3) rekomandime nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që të eliminohen arsyet apo pengesat e plotësimit të pozitës së zyrtarit të pasurisë.	Në këtë pozitë ishte caktuar një zëvendësues nga janari i vitit 2021 deri në rekrutim të rregullt të pozitës.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruar nga MAPLja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.	Ky rekomandim nuk ishte zbatuar dhe ende figurojnë avance të hapura.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me departamentin e monitorimit duhet të	Edhe këtë vit kemi identifikuar	Nuk ka filluar zbatimin

		sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar dhe fshirë të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.	projekte të përfunduara që nuk i janë bartur komunave.	
4.	Auditimi Brendshëm	Ministri duhet të siguroj funksionimin e Komitetit të Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.	Edhe këtë vit KA nuk ishte funksional dhe nuk kishte mbajtur asnjë takim.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Fjolla Bakalli, Udhëheqëse e ekipit




Burbuqe Idrizi, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Elbert Krasniqi   
Ministër-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Data: 10 qershor 2022



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.